



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0184

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga : Agon Ramadani – Kryetarë, Vjosa Gradinaj–Anëtar, dhe Vedat Poterqoi Antarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Rimi Eng” sh.p.k me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Menaxhimi i projekteve-Kontratave investive në Komunën e Lipjanit.” me numër të prokurimit 613-23-652-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Lipjan, më 12/07/2023, mori këtë

Vendim

1. Anulohet, në tërësi aktiviteti i prokurimit “Menaxhimi i projekteve-Kontratave investive në Komunën e Lipjanit.”, me numër të prokurimit 613-23-652-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues, Kuvendi Komunal Lipjan.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
3. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 27.03.2023, Kuvendi Komunal Lipjan, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin Autoritetit Kontraktues për Dhënie të Kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: “Menaxhimi i projekteve-Kontratave investive në Komunën e Lipjanit.”, me numër të prokurimit 613-23-652-2-2-1, ka rekomanduar për kontratë grupin e OE NPN ”Universi Mi & Instituti i Shkencës Dhe Teknologjisë Insi sh.p.k., në vlerë totale të kontratës

2.37€

Me datë 31.03.2023, Operatori Ekonomik "Rimi Eng" sh.p.k., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Kuvendi Komunal Lipjan, me datë 31.03.2023, AK eka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 27.03.2023.

Me datën 04.04.2023 Operatori Ekonomik "Rimi Eng" sh.p.k., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 184/2023, kundër B58 Njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie kontratës për aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës, shërbim, vlerë e mesme, kontratë publike kornizë me një OE vlera e parashikuar e kontratës: 100,000.00 €.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 06 prill 2023 me raportin e ekspertizës. AK Kuvendi Komunal Lipjan, ka deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, ndërkaq OE Me datë 23 janar 2023 OE "Rimi Eng" sh.p.k., ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 06.04.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE "Rimi Eng" sh.p.k., të aprovohet si e bazuar.

- të anulohet njoftimit për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

-Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues

Sqarim Hyrës

Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës Lipjan, gjatë këtij aktiviteti ka aplikuar procedurën e hapur, vlerë e mesme, lloji i kontratës shërbim, kontratë publike kornizë me një OE vlere e parashikuar 100,000.00 €

Grupi i OE ankues, për herë të parë ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim me dt. 13.03.2023 dhe AK me dt. 16.03.2023 kishte nxjerr vendimin mbi aprovimin e pjesërishëm të kërkesës dhe lëndën e kishte kthyer ne ri-vlerësim. AK me datë 27.03.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK për herë të dytë duke eliminuar grupin e OE ankues me arsyetimin se ka gabim aritmetik mbi 2% ndërsa ka rekomanduar për kontratë grupin e OE NPN "Universi Mi & Instituti I Shkencës Dhe Teknologjisë Insi sh.p.k., në vlerë totale të kontratës 2.37€.

Grupi i OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK, me date 30.03.2023 përsëritë kërkesën për Rishqyrtim me pretendime të njëjta si në kërkesën e datës 13.03.2023. AK dt. 31.03.2023, nxjerr vendimin me të cilin e refuzon në tërësi si të pa bazuar kërkesën për ri-shqyrtim te grupit te OE ankues.

Grupi i OE ankues, i pakënaqur me vendimin e AK-së me dt.: 03.04.2023 paraqet ankesë në OSHP me pretendime të njëjta ankimore me ato të paraqitura tek AK. OE ankues, në ankesën ka paraparë pretendime ankimore lidhur me kriteret e aplikuara tek kapacitetit teknik profesional lidhur me stafin e kërkuar, dëshmitë nga neni 65 dhe përkrahimin e çmimit.

Përgjigje në Pretendimet e OE ankues

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se parashtruesi i ankesës në kërkesën për Ri-shqyrtim dhe ankesë, pretendon se grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmitë që përmbushin kërkesën e stafit si psh: 2 Inxhinier te diplomuar te ndërtimtarisë - drejtimi Infrastruktura rrugore, sistemi 5 vjeçar ose master (min.5 vjet provojë pune nga diplomimi) Pika g) 1 gjeodet bachelor apo master i licencuar, (min.5 vjet provojë pune nga diplomimi). Mungon njohja e diplomës sipas Ligjit ne fuqi ne Republikën e Kosovës gjegjësisht LIGJIT Nr. 04/L-037 të cilin po e sjellim më poshtë të skanuar dhe si provë ka bashkangjitur udhëzimin administrative nga MASHT për nostrifikimin e diplomave.

Vlen të cek se AK nuk kishte kërkuar në dosje të tenderit që diplomat të dorëzohen të nostrifikuara por vetëm ka kërkuar kopjen e diplomës shih dëshminë për kërkesën e dosjes lidhur me stafin e kërkuar. “Dëshmia 2. Lista e stafit duhet të dorëzohet e nënshkruar dhe e vulosur nga OE që duhet të përmbajë emrin, mbiemrin, profesionin dhe pozicionin. a). Për stafin profesional, të dëshmojnë me Diplome dhe CV, licenca e gjeodetit me validitet. Për te gjithë stafin Kontratat e punës ose para kontrata për këtë projekt”. Andaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i parë i palës në ankesë sa i përket nostrifikimit të diplomave nuk qëndron.

Pala në ankesë e konteston dokumentet që kanë të bëjnë me konzerciumin e operatorëve ekonomik, duke pretenduar se vërtetimet e dorëzuara nga grupi i OE nuk i përmbushin kriteret e nenit 65 të LPP-së pranueshmërinë e kandidatëve, sepse pretendon që janë me afat të skaduar duke nën-vizuar me ngjyrë të verdhë datën e pretenduar të lëshimit të dokumentit. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, sqarojmë se parashtruesi i ankesës ka nën-

vizuar me ngjyrë të verdhë datën gabim pasi që ajo tregon bazën ligjore mbi të cilën Gjykata e mbështet nxjerrjen e certifikatës dhe jo datën e dokumentit. Dy anëtar të konzerciumit kanë dorëzuar certifikata nga gjykata e që janë lëshuar me dt. 29.10.2022 dhe njëri anëtar ka paraqitur certifikatën nga gjykata të datës 10.01.2023 dhe nuk janë lëshuar me dt.29.07.2022 siç pretendon pala në ankesë. Andaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë sa i përketë datave të certifikatave nuk qëndron.

Më tej pala në ankesë kundërshton përshkrimin e çmimit sepse ka vendosur tekst me dy-kuptime dhe AK duke interpretuar për interesa të veta ka eliminuar ofertën tone. Pas administrimit të fakteve dhe provave eksperti shqyrtues sqaron se, AK për këtë aktivitet ka aplikuar procedurën e hapur vlera e mesme shërbim, kontratë publike kornizë me një OE dhe ka vendosur si kriter të dhënies së kontratës tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Referuar nenit 54.10 të rregullores për Prokurim Publik Nr. 001/2022 kur AK inicion kontratë publike kornizë me një OE “Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative. Kurdo që Autoriteti kontraktues specifikon sasinë indikative, Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijimin prej tij, duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%)”. Nëse AK deklaron përqindjen e mospërputhjes në dosje të tenderit dhe nëse urdhër blerjet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë + tridhjetë përqind (30%), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht. Mospërputhja e lejuar plus/minus tridhjetë përqind (30%) vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull, dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëjë porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Neni 54.15 i po të njëjtës rregullore parasheh “Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë së secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%), si p.sh. mirëmbajtje të veturave, mirëmbajtje të gjeneratorëve etj. në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar. Shuma e sigurimit të ekzekutimit të kontratës në këto raste duhet të përcaktohet si shumë fikse. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (riparime dhe mirëmbajtje)”.

Bazuar në këtë ekspert shqyrtues sqaron se, AK në përshkrimin e çmimit ka kërkuar që çmimi për njësi nga OE të vendoset me % dhe jo në euro, gjë e cila është në kundërshtim me nenin 20 të dosjes së tenderit 20. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit, 20.1 Të gjitha çmimet e specifikuar në tender duhet të deklarohen në Euro (€) dhe duhet të përfshinë të gjitha taksat e aplikueshme, detyrat dhe pagesat tjera. Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës. Bazuar në LPP dhe dosje të tenderit çmimi duhet të deklarohet vetëm në euro dhe jo në % siç ka kërkuar AK.

Përveç kësaj AK, tek përshkrimi i çmimit ka paraparë gjithsej 3 pozicione njësi matëse ishte vlera e kontratës, sasia/indikative është për secilin pozicion vetëm një (1), çmimi njësi është

kërkuar me % dhe jo në euro. Mbi këtë fakt, konstatoj se AK ka aplikuar gabimisht kontratën publike kornizë me një OE për fakti se “Mospërputhja e lejuar konsiston në plus/minus tridhjetë përqind (30%) bazuar në vlerën e kontratës së propozuar e që është 2.37€ vlerë kjo e cila mund të ketë devijim +/-30% është e pamundur të realizohet kontrata në vlerë prej 100,000.00€ sa është e parashikuar.

AK po ashtu nuk ka aplikuar formulën në bazë të rëndësisë apo çmimi më i lirë me poentim, sipas kësaj “Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshat në baze të rëndësisë se secilës “kategori të shërbimeve” ose secilit “artikull” në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben vetëm për qëllim të vlerësimit të ofertave ndërsa kontrata lidhet me çmime për njësi dhe mund të realizohet deri në vlerë të parashikuar.

Pavarësisht asaj se asnjë nga OE nuk ka kërkuar sqarime shtesë gjatë afatit kohor të dosjes së tenderit. AK, është dashur që të anulohet komplet aktiviteti i prokurimit konform nenin 62 paragrafi 1.1 “një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit”. E jo të rekomandoj për kontratë asnjë OE për faktin se gabimi i bërë nga AK është i pa-përmirësueshëm në këtë fazë, ky gabim ka ndikuar që AK të pranoj vetëm dy oferta për këtë aktivitet të prokurimit dhe atë me çmime të pa-shpjegueshme njëra në vlerë prej 0.89€ dhe tjetra në vlerë prej 2.37€ kurse vlera e parashikuar është 100,000.00€. AK kishte kërkuar nga OE që të ofertën e tyre ta deklarojnë me % dhe jo në euro *Çmimi duhet te jepet ne përqindje të vlerës së kontratës se menaxhuar. Andaj, në përputhje me konstatimet e mësipërme vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë sa i përket përshkrimit të çmimit qëndron

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë të anulohet njoftimi për kontratë dhe nëse AK më tutje ka interes, aktivitetin e prokurimit ta ritenderojë.

Paneli shqyrtues thekson faktin se asnjë nga OE nuk ka kërkuar sqarime shtesë gjatë afatit kohor të dosjes së tenderit, mirëpo AK, është dashur që të anulohet komplet aktiviteti i prokurimit konform nenin 62 paragrafi 1.1 “një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit”, e jo të rekomandoj për kontratë ndonjë OE për faktin se gabimi i bërë nga AK është i pa-përmirësueshëm në këtë fazë, ky gabim ka ndikuar që AK të pranoj vetëm dy oferta për këtë aktivitet të prokurimit dhe atë me çmime të pa-shpjegueshme njëra në vlerë prej 0.89€ dhe tjetra në vlerë prej 2.37€ kurse vlera e parashikuar

është 100,000.00€. Andaj, Ak gjatë hartimit të Dosjes së tenderit ka vepruar në kundërshtim me nenin 27 të LPP dhe dispozitat ligjore të cilat i ka cituar eksperti shqyrtues.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendi mi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - " RIMI ENG " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: